



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 91

Tiranë – E mërkurë, 20 maj 2020

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 42/2020 datë 23.4.2020	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 64/2012 “Për peshkimin”, të ndryshuar..... 5409
Ligj nr. 54/2020 datë 30.4.2020	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7643, datë 2.12.1992, “Për inspektimin sanitar”, të ndryshuar..... 5409
Dekret i Presidentit nr.11484, datë 19.5.2020	Për shpallje ligji..... 5411
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 401, datë 19.5.2020	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.5, datë 6.1.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”..... 5411
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.173, datë 14.3.2020	Për ndalimin e të gjitha lëvizjeve të mjeteve të transportit në pikat kufitare tokësore..... 5411
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 3890, datë 20.5.2020	Për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti, “Ndërtimi i rrugës që lidh rrugën “Tish Daia”, me rrugën “Robert Shvarc”..... 5412
	Vendim (i shkurtuar) për shpalljen të vdekur të shtetasit Nevruz Harizaj..... 5415



LIGJ
Nr. 42/2020

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË LIGJIN NR. 64/2012 “PËR
PESHKIMIN”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 30 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Numri maksimal i lejeve të peshkimit tregtar artizanal përcaktohet nga ministri, në zbatim të planit të menaxhimit të peshkimit dhe të planit të zbatimit të peshkimit.”.

2. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Leja e peshkimit tregtar ka një kohëzgjatje 10-vjeçare, e cila tregohet qartë në leje. Me mbarimin e këtij afati, leja rinovohet pas dorëzimit më parë të kërkesës përkatëse nga ana e pronarit të anijes së peshkimit.”.

3. Pas pikës 7 shtohen pikat 8, 9, 10 dhe 11 me këtë përmbajtje:

“8. Leja e peshkimit jepet për anijet e peshkimit të regjistruara në regjistrin e anijeve të peshkimit dhe të pajisura me numrin unik identifikues NFR.

9. Të gjitha anijet e peshkimit të regjistruara në regjistrin e anijeve të peshkimit dhe të pajisura me NFR, por që u ka mbaruar afati i vlefshmërisë së lejes së peshkimit dhe nuk e kanë rinovuar atë, kanë të drejtë të aplikojnë për rinovimin e lejes së peshkimit, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

10. Nuk lëshohen leje të reja peshkimi për anijet e peshkimit që zhvillojnë format e peshkimit me rrjeta tërheqëse (fundore ose pelagjikë, veçmas ose së bashku), me rrethim (koshilok) për peshkimin e

pelagjikëve të vegjël dhe të mëdhenj, dragat hidraulike (turbosofiante), linja grepash dhe të gjitha format e peshkimit tregtar profesional. Për anijet e peshkimit që zhvillojnë format e peshkimit me rrjeta tërheqëse, të cilat janë të pajisura me leje peshkimi për të dyja format së bashku, lejohet ndryshimi i lejes duke kaluar vetëm në rrjeta tërheqëse fundore.

11. Leje të reja të peshkimit jepen vetëm për anije peshkimi:

a) me tonazh dhe fuqi motorike më të vogël ose të barabartë me një anije peshkimi me leje të vlefshme peshkimi, si zëvendësim i saj;

b) të mbytura, të cilat ishin të pajisura një leje të vlefshme peshkimi, si zëvendësim i saj. Në këtë rast kërkesën për leje peshkimi e bën pronari i anijes së mbytur ose trashëgimtarët e tij.”.

Neni 2

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 23.4.2020

LIGJ
Nr. 54/2020

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË LIGJIN NR. 7643, DATË 2.12.1992,
“PËR INSPEKTIMIN SANITAR”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 7643, datë 2.12.1992, “Për inspektimin sanitar”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:



Neni 1

Kudo në përmbajtjen e ligjit, fjalët “inspektorati që mbulon fushën e shëndetit” zëvendësohen me fjalët “struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit” dhe fjalët “Drejtoria e Shëndetit Publik” zëvendësohen me fjalët “Struktura përgjegjëse për shëndetin publik”.

Neni 2

Në nenin 1/1, pikat 5 dhe 6 shfuqizohen.

Neni 3

Në nenin 2, pas paragrafit të parë shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Bën përjashtim nga ky ligj inspektimi sanitar në fushën e ushqimit dhe ushqimit për kafshë, inspektim i cili do të bëhet nga institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë.”.

Neni 4

Në nenin 10 bëhen këto ndryshime:

a) Paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

“Struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit është përgjegjëse për kontrollin dhe zbatimin e ligjeve e të akteve nënligjore sanitare dhe pajis me akt miratimi higjieno-sanitar subjektet në sektorët publikë dhe jopublikë, sipas përcaktimeve të këtij neni. Marrëdhëniet e punësimit të punonjësve dhe inspektorëve të strukturës përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit rregullohen sipas dispozitave të parashikuara në Kodin e Punës.”.

b) Nënndarja e parë, pas paragrafit të parë, ndryshohet si më poshtë:

“- në objektet e prodhimit, të ruajtjes, të magazinimit, të transportimit e tregtimit të produkteve të të gjitha llojeve, përjashtuar objektet e prodhimit, të ruajtjes, të magazinimit, të transportimit e tregtimit të produkteve ushqimore.”.

Neni 5

Neni 12 shfuqizohet.

Neni 6

Në nenin 13 bëhen këto ndryshime:

a) Në shkronjën “c”, hiqen fjalët “si dhe analizën e hazardëve dhe kontrollin në pikat kritike në të gjithë zinxhirin për prodhimin e produkteve ushqimore.”.

b) Shkronja “ç” shfuqizohet.

Neni 7

Në nenin 16 hiqen fjalët “produkteve ushqimore e të”.

Neni 8

Në nenin 19, nënndarja e parë ndryshohet si më poshtë:

“- prodhimin, ruajtjen, transportimin, tregtimin e produkteve kozmetike në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në legjislacionin përkatës dhe normat sanitare.”.

Neni 9

Neni 20 shfuqizohet.

Neni 10

Në nenin 26 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Pikat 2, 3, 5 dhe 12 shfuqizohen.

b) Pikat 4 e 14 ndryshohen si më poshtë:

“4. Papastërtitë personale e të mjeteve të punës në objektet e përcaktuara në nenin 10 të këtij ligji.

14. Mosmarrja e aktmiratimit prej strukturave përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit nga subjektet e përcaktuara në nenin 10 të këtij ligji.”.

Neni 11

Në nenin 27 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në nënndarjen e parë hiqen numrat “2” dhe “3”.

b) Në nënndarjen e dytë hiqet numri “12”.

c) Në nënndarjen e tretë hiqet numri “5”.



Neni 12
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 30.4.2020

Shpallur me dekretin nr. 11484, datë 19.5.2020, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

DEKRET
Nr. 11484, datë 19.5.2020

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 54/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.7643, datë 2.12.1992 “Për inspektimin sanitar”, të ndryshuar”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

VENDIM
Nr.401, datë 19.5.2020

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR.5, DATË 6.1.2020, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE
TË PROCEDURAVE PËR PËRFITIMET
NGA PROGRAMI I GRANTEVE TË
RINDËRTIMIT DHE PROJEKTET
MODEL”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 18, 19, 20 e 25, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miraturar me ligjin nr.97/2019, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në kreun IV, të vendimit nr.5, datë 6.1.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Shkronja “b”, e pikës 2, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“b) projektin e rikonstruksionit ose listën e punimeve të riparimit dhe preventivin e punimeve që kërkohen të financohen nëpërmjet grantit për individët ose familjet që përfitojnë vlerën e plotë të rikonstruksionit, sipas pikës 3, të këtij kreu, hartuar nga Instituti i Ndërtimit, njësitë e vetëqeverisjes vendore apo projektuesit e licencuar.”.

b) Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Masa e vlerës së rikonstruksionit ose riparimit, kontrata tip për përfundimin nga grantet e rikonstruksionit për individët ose familjet, sipas pikës 4, të këtij vendimi, miratohen me vendim të këshillit bashkiak të njësisë së vetëqeverisjes vendore, e cila, në të gjitha rastet, nuk duhet të jetë më shumë se:”.

c) Në shkronjën “b”, të pikës 7, pas fjalës “... e vlerës ...” shtohen fjalët “... të preventivit të punimeve ...”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ministri i Shtetit për Rindërtimin, Enti Kombëtar i Banesave dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

URDHËR
Nr. 173, datë 14.3.2020

**PËR NDALIMIN E TË GJITHA
LËVIZJEVE TË MJETEVE TË
TRANSPORTIT NË PIKAT KUFITARE
TOKËSORE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 3, gërma “a” të ligjit nr.15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, si edhe në përputhje me Rregulloren Ndërkombëtare të Shëndetit, vendimin e Komitetit të Përkohshëm për infeksionin e përhapur nga Coronavirus i ri, me qëllim mbrojtjen



e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e lëvizjeve me mjetet e transportit për udhëtarët (autobuza, autovetura etj.), në hyrje dhe në dalje në pikat e kalimit kufitar tokësor duke filluar nga ora 23:59 e datës 15.3.2020. Ky kufizim do të qëndrojë në fuqi deri në një urdhër të dytë të ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

2. Përjashtim nga rregulli i caktuar në pikën 1 bëjnë mjetet e transportit për mallrat, produkte ushqimore, barna dhe pajisje mjekësore dhe produkte të tjera të nevojshme për shërbimin shëndetësor.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Inspektorati Shtetëror Shëndetësor dhe Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor të bashkëpunojë me autoritetet përgjegjëse për kufirin dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

KËRKESË

Nr. 3890, datë 20.5.2020

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti, “Ndërtimi i rrugës që lidh rrugën “Tish Daia”, me rrugën “Robert Shvarc”, Tiranë.

Subjekti kërkuar i këtij projekti është Bashkia Tiranë.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në vendimet vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 89, datë 3.2.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, dhe në vendimet të Këshillit të Ministrave nr.138, datë 23.8.2000 “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 89 584 546 (tetëdhjetë e nëntë milionë e pesëqind e tetëdhjetë e katër mijë e pesëqind e dyzet e gjashtë) lekë.

ZËVENDËSMINISTËR
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMEVE
Artan Shkreli



Llogaritjet paraprake për pasuritë që preken nga projekti "Ndërtimi i rrugës që lidh rrugën "Tish Daia" me rrugën "Robert Shvarc"

Nr.	Emër AtësiMbiemër	Pjesa takuese	Z.K.	Nr. pasurisë	Sip. Përgj. Truall(m²)	Sip. prekur truall (m²)	Çmimi për truall(lekë/m²)	Vleratruall prekur (lekë)	Sip. e gjurmës së Objektitsi pas kartelës(m²)	Sip. e përgj. Ndërtimi e Objektit sipas kartelës (m²)	Sip. prekur Objekt(m²)		ÇMIMI përObjektbanimi (lekë/m²)	VLERAsip. prekur Objekt, shërbimi, me situacion(lekë)	VLERAsip. prekur Objektbanimi(lekë/m²)	VLERAePërgj. truall + objekt (lekë)	KONFIRMIM ASHK TIRANË	SHËNIME
											Sip. Shërbimi (m²)	Sip. Banimi(m²)						
1	BP.Vorpsi, Kika, Dalipi(Arjeta Muharrem Dalipi,Sadete Shaban Kika,Lirie Qazim Lika, Vjollca Vorpsi,Bardhyl Kika, Avenir Kika,Halil Qazim Kika, Afërdita Qazim Vorpsi,Alda Kujum Kika, Flutura Qazim Kika,Klejda Kujum Kika,Lulëzim Qazim Kika,Sokol Muharrem Kika,Vera Kika)	24 / 216, 24 / 216, 12 / 216, 12 / 216, 24 / 216, 24 / 216, 12 / 216, 12 / 216,8 / 216,12 / 216, 8 / 216,12 / 216, 24 / 216, 8 / 216	8260	6/739	66.8	66.8	30783	2056304,40								2,056,304	Konfirmohet me shkresën nr. prot.1099/1, datë 17.06.2019 të ASHK Drejtoria Vendore, Tirana Jug	
2	Afërdita Qazim Vorpsi		8260	6/731	526.58	80	30783.0	2462640								2,462,640	Konfirmohet me shkresën nr. prot.1099/3, datë 09.07.2019, të ASHK , Drejtoria Vendore, Tirana Jug.	
3	Liri Qazim Kika		8260	6/351	250	3	30783	92349								92,349	Konfirmohet me shkresën nr. prot.1099/1, datë 17.06.2019 të ASHK Drejtoria Vendore, Tirana Jug	
10	Petrit Çullhaj,Faik Çullhaj		8260	4/753	100	10	30783	307830								307,830	Konfirmohet me shkresën nr. prot.1099/1, datë 17.06.2019 të ASHK Drejtoria Vendore, Tirana Jug	
11	Afërdita Qazim Vorpsi		8260	4/754	810	228	30783	7018524								7,018,524	Konfirmohet me shkresën nr. prot.1099/1, datë 17.06.2019 të ASHK Drejtoria Vendore, Tirana Jug	
12	Myzafer Sami Memushi, Myfit Sami Hamataj	1 / 2, 1 / 2	8260	4/466	1931	8	30783	246264	293							246,264	Konfirmohet me shkresën nr. prot.1099/1, datë 17.06.2019 të ASHK Drejtoria Vendore, Tirana Jug	në seksionin "D" ka shënimin mbi këtë truall ndodhet pasuria nr. 4/379/ND, në favor të Qamile Plaku" dhe në seksionon "E" ka shënimin "ka 7 ndërtime pa leje. Të kufizohen veprimet deri në momentin e plotësimit të dokumentacionit"
20	BP. Vorpsi, Kika, Lika(Avenir Ali Kika,Sadete Shaban Kika,Lirie Qazim Lika, Vjollca Qazim Vorpsi,Bardhyl Ali Kika,Afërdita Qazim Vorpsi,Alda Kujum Kika,Flutra Qazim Kika,Klejda Kujum Kika,Lulëzim Qazim Kika,Sokol Muharrem Kika,Vera Kika,Arjeta Muharrem Dalipi)	24 / 216, 24 / 216, 12 / 216, 12 / 216, 12 / 216, 12 / 216, 24 / 216, 12 / 216, 8 / 216,12 / 216, 8 / 216,12 / 216, 24 / 216, 8 / 216,24 / 216	8260	6/741	762	375	30783	11543625								11,543,625	Konfirmohet me shkresën nr. prot.1099/1, datë 17.06.2019 të ASHK Drejtoria Vendore, Tirana Jug	
21	Besnik Shyqyri Sinani		8260	6/716	166.34	142	30783	4371186								4,371,186	Konfirmohet me shkresën nr.	Në seksionin "E" ka shënimin "Bllokohet në favor të



																	prot.1099/1, datë 17.06.2019 të ASHK Drejtoria Vendore, Tirana Jug	ProCredit Bank sh.a. Për shumën 500000 Euro".	
22	Edmond Dervishi, Lindita Hasko (Dervishi),Shpresa Dervishi	1 / 3, 1 / 3, 1 / 3	8260	6/697	133	133	30783	4094139	72	143	0	143	101278		14523265	18,617,404	Konfirmohet me shkresën nr. prot.1099/3, datë 09.07.2019 dhe me shkresën nr. prot.7954/3, datë 29.10.2019, të ASHK Drejtoria Vendore, Tirana Jug, si edhe me shkresën nr. prot. 10934/1, datë 21.01.2020	Ndërtesa është 2 kate, sipas shkresës nr. prot. 16143/1, datë 21.06.2018, të ZVRPP Tiranë (leje legalizimi, e planimetri) rezulton sip. Kati përdhe = 72 m2 sip. Kati i parë = 71.4 m2. Dhe sip përgjith. = 143.4 m2 me funksion banesë.	
23	Mustafa Alush Gjata		8260	6/699	170	170	30783	5233110	92	213	91.9	121	101278	2747725	12254638	20,235,473	Konfirmohet me shkresën nr. prot.1099/1, datë 17.06.2019 dhe me shkresën nr. prot.7954/3, datë 29.10.2019, të ASHK Drejtoria Vendore, Tirana Jug, si edhe nr. prot. 10934/1, datë 21.01.2020	Ndërtesë 2 kat me funksion të kombinuar. Kati përdhe = 91.9 m2 me funksion social ekonomik, Kati i parë = 121 m2 funksion banim. Dhe sip përgjith. = 212.9 m2.	
24	BP. Sinani, Merja (Tadije Qazim Sinani, Lucie Gani Merja, Dishir Gani Sinani,Shkelqim Gani Sinani, Fatos Gani Sinani, Rushan Gani Sinani,Agron Gani Sinani)	1 / 7, 1 / 7, 1 / 7, 1 / 7, 1 / 7, 1 / 7	8260	6/638/ND					158.90	158.90	0.00	158.90	101278.00		0.00	16093074.20	16,093,074	në përshkrimin e veçantë të kartelës së pasurisë ka shënimin "Pjesë e kësaj pasurie është pasuria me nr.6/638/ND+1-1, vol.56, fq.195.Pasuria është e pajisur me certifikatë pronësie".Në seksionin E të kartelës së pasurisë ka shënimin "Kjo ndërtesë nuk ka mardhënie të zgjidhura me truallin, ndodhet mbi trojet me nr. 6/742, 6/741 dhe 6/720 z.k. 8260".	
25	Anife Bilbil Shoraj		8260	6/638/ND+1-1					28.10	28.10	0.00	28.10	101278.00		0.00	2845911.80	2,845,912	Konfirmohet me shkresën nr. prot.1099/3, datë 09.07.2019, të ASHK , Drejtoria Vendore, Tirana Jug, si dhe me shkresën nr. prot.7954/3, datë 29.10.2019, si edhe nr. prot. 10934/1, datë 21.01.2020	
26	Eduard Minella Gjini		8260	6/325	372	120	30783	3693960								3,693,960	Konfirmohet me shkresën nr. prot.1099/1, datë 17.06.2019 të ASHK Drejtoria Vendore, Tirana Jug	Në seksionin "E" ka shënimin "Ka 2 ndërtime pa leje. Të kufizohen veprimet deri në momentin e plotësimit të dokumentacionit". Në seksionin D ka shënimin "mbi këtë truall ndodhet ndërtesa me nr. pas. 6/27-ND.	
SHUMA			1335.8													89,584,546			

SHËNIM:

1. Pasuritë e prekura nga projekti, Konfirmohen me shkresat nr. prot.1099/1, datë 17.06.2019, nr. prot. 1099/3, datë 09.07.2019, nr. prot. 7954/3, datë 29.10.2019, si edhe nr. prot. 10934/1, datë 21.01.2020, të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore, Tirana Jug.
2. Për truallin, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM nr. 89, dt. 03.02.2016.
3. Për objektet me funksion social – ekonomik, vlerësimi është bërë me metodën e kostos së ndërtimit, bazuar në çmimet mesatare sipas zërave të punës për qytetin e Tiranës, të vëna në dispozicionin tonë nga Enti Kombëtar i Banesave, me shkresën me nr. prot. 684, datë 27.03.2018.
4. Për objektet me funksion banimi, çmimi për llogaritje është marrë çmimi mesatar për objekt banimi vënë në dispozicionin tonë me shkresën nr. prot. 2149/4, datë 30.04.2020, të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore, Tirana Jug.

**VENDIM***(i shkurtuar)*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat me vendimin nr. 31, datë 28.1.2020 vendosi shpalljen të vdekur në datën 8.8.2001 të shtetasit Nevruz Harizaj, i datëlindjes 9.3.1920, lindur në Sevran Pëmet.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 84 lekë